

### Drejt finalizimit marrëveshja për njohjen e sigurimeve shoqërore për shqiptarët në Itali



Marrëveshja e njohjes së sigurimeve shoqërore për shqiptarët në Itali, pranë finalizimit, lajmi u bë i ditur gjatë një konference të përbashkët shtypi të kryeministrit shqiptar dhe italianë, pas takimit të tyre ditën e enjte. "Me vjen shumë mirë që bashkëpunimi i nisur në këtë drejtim është konfirmuar nga kryeministri dhe ne do të vazhdojmë dhe do të përshejtojmë përpjekjet për të përfunduar këtë marrëveshje që ka një rëndësi të madhe për ekonominë e këtyre familjeve, për dinjitetin e këtyre njerëzve por edhe për miqësinë tradicionale mes dy popujve tanë", tha kryeministri Rama. Ndërsa kryeministri italian vlerësoi kontributin e shqiptarëve në ekonominë italiane dhe tha se një marrëveshje për pensionet mund të jetë shumë pranë finalizimit.

### Ansambli Kombëtar koncert për komunitetin shqiptar në Ukrainë



Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore u ngjiti mbrëmjen e së enjtes në skenën e Teatrit Akademik të Komedisë Muzikore në Odessa me një repertor të lamshëm tradicional, në një koncert të dedikuar për komunitetin shqiptar në Ukrainë. Ky aktivitet i cili u organizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës u zhvillua në zbatim të programeve që agjencia ka për shqiptarët e Ukrainës. Më herët në kuadër të Marrëveshjes me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, janë organizuar klasa të mësimt të valleve dhe kulturës shqiptare për komunitetin shqiptar në Karakurt, Tyushki, Divynyn's'ke dhe Gamovka.

### Nis konsulta publike për Projekt Strategjinë Kombëtare për Diasporën dhe Planin e Veprimit 2021 – 2025

Qëllimi i procesit të konsultimit është mbledhja e sugjerimeve nga qytetarët, shoqëria civile, akademikët dhe shoqatat shqiptare për përmirësimin e mëtejshëm të këtij dokumenti, si dhe për zbatueshmërinë e masave të parashikuara në të. Projekt-Strategjia do të kalojë në disa faza: **Faza I:** Mbledhja e opinionëve me shkrim nga individë dhe ekspertë të ndryshëm (brenda muajit nëntor 2019). **Faza II:** Diskutimi në publik i projekt-dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës (brenda muajit mars 2020). **Faza III:** Përmbledhja dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare (brenda muajit qershor 2020). Nëpërmjet këtij njoftimi, ju ftojme të jepni kontributin tuaj mbi dokumentin e rishikuar të Strategjisë. Ky konsultim do të jetë i hapur nga data 30 tetor 2019 deri më 30 nëntor 2019 në këtë link: <http://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/224>

### Marrëveshja për shqiptarët që vuajnë heqjen e lirisë në Itali, drejt finalizimit

Marrëveshja për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në Itali, kryeministri italian deklaroi se po punohet intensivisht me Shqipërinë për finalizimin e marrëveshjes. "Kemi kryer një studim për bashkëpunimin tashmë intensiv në gjyqësor dhe polici. Unë përsëris angazhimin e Italisë për forcimin e këtij bashkëpunimi, me vëmendje të veçantë në luftën kundër krimit të organizuar dhe jame i kënaqur që mund të njoftoj se është arritur një marrëveshje edhe në sektorin e rëndësishëm të transferimit të të burgosurve shqiptarë, tashmë një transferim i parë do të realizohet së shpejti", u shpreh kryeministri italian Giuseppe Conte. Kjo marrëveshje do të jetë rezultat i grupit të punës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, i cili kryesuar nga zëvendësministria e Drejtësisë, znj. Fjoralba Caka e cila është personi përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit.

### Vizita në Ukrainë / Takime me përfaqësues të lartë të qeverisë

Këtë javë, ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi një vizitë pune në Ukrainë. I shoqëruar nga Konsulli i nderit Nderit të Republikës së Shqipërisë në Ukrainë, z. Shahin Omarov, ministri Majko është takuar me zëvendësministren për Integrimin në Evropë, në ministrinë ukrainase për Infrastrukturën, znj. Oleksandra Klitina, për të diskutuar rreth marrëdhënieve të përbashkëta mes dy vendeve. Ministri Majko është takuar edhe me z. Bohdan Yaremchenko, kryetari i Komitetit Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe Bashkëpunimin ndërkombëtar Ndërkombëtar në Këshillin e Lartë të Ukrainës, ku fokusi i bisedës ishin ishin marrëdhëniet Shqipëri-Ukrainë, si dhe vëmendja ndaj komunitetit shqiptar në Ukrainë.

Gjithashtu, ai ka zhvilluar takim pune me zëvendësministren e Arsimit dhe të Kulturës në Ukrainë, znj. Mandzi Lubomira, me të cilën u diskutua për marrëdhëniet mes dy vendeve dhe studentët me origjinë shqiptare, të cilët ndjekin studimet në Ukrainë. Një tjetër takim i rëndësishëm ishte edhe ai me zëvendësministren e Kulturës në Ukrainë, znj. Sviltana Fomenko, ku u bisedua për mundësinë e një bashkëpunim ndërinstitucional mes dy vendeve me qëllim hartimin e projekteve të përbashkëta kulturore, fokusi i të cilave do të jetë mbështetja e komunitetit shqiptar në zona të ndryshme të Ukrainës.

**PROJEKT STRATEGJIA KOMBËTARE PËR DIASPORËN DHE PLANI I VEPRIMIT, 2021-2025**  
Për rishikimin dhe miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2021-2025



### Bashkëpunimi për hapjen e një qendre kulturore "Palazzo Albani", Itali



Gjatë një takimi me senatorin Paulino Uccielli, kryetari i Bashkisë së Vallefoglia, Itali dhe me presidentin e shoqatës shqiptare "Agimi" në Itali, z. Edmond Kumaraku u bisedua për mundësinë e një bashkëpunimi institucional, me qëllim hapjen e një qendre të shkëmbimit kulturor dhe shkencor në "Albani", pallati mbretëror i familjes Albani me origjinë shqiptare në Urbino. Funkcioni i kësaj qendre do të jetë mbështetja e komunitetit shqiptar në krahinat e ndryshme të Italisë si dhe mundësia e krijimit të shkëmbimeve kulturore dhe shkencore midis institucioneve.

### Me delegacionin e Dhomës së Tregtisë së Athinës



### SHBA/ Dy shqiptarë në zgjedhjet e datës 5 nëntorit



Më datë 5 nëntor, në SHBA mbahen zgjedhjet lokale. Mes kandidatëve për këshillat bashkiakë janë edhe kandidatët shqiptarë, Visar Tasimi dhe Jetir Kulla. Tasimi, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, ka lindur në SHBA dhe kandidon për herë të parë në këshillin bashkiak të Naugatuck, në Connecticut. Kulla ka shkuar që fëmijë në SHBA dhe kandidon për mandatin e tretë në këshillin bashkiak të qytetit Waterbury. Ai shprehet krenar për këtë arritje dhe për përfaqësimin në këshill, ndërsa Visari shpreson shumë në një angazhim më të madh të rinisë në qeverisjen lokale.

### KKD / Mark Gjonaj në protestën e shqiptarëve #RallyForHerJustice



Komuniteti shqiptarë, kroate dhe boshnjake organizuan një manifestim unik në Nju-Jork, SHBA, kundër krimeve serbe. Protesta shënoi fillimin e lëvizjes #RallyForHerJustice, e cila synon t'u japë zë mijëra viktimave të abuzimeve gjatë luftës. Kësaj proteste iu bashkua këshilltari i bashkisë së Nju-Jorkut dhe anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës z. Mark Gjonaj.

### KKD / Adriana Bejko thirrje për ruajtjen e gjuhës shqipe në Diasporë

Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, Adriana Fishta Bejko i u ka bërë thirrje të gjitha shoqatave shqiptare në Kanada dhe më gjerë, që ceremonitë festive të organizuara për këtë 107-vjetor të ditës së Pavarësisë të jenë edhe fushata sensibilizimi për gjuhën shqipe. "Në emër të bijve dhe bijave tona që po rriten në dhe të huaj, ju bëj thirrje të përgjyruar të gjitha shoqatave shqiptare në Kanada dhe më gjerë, që këtë nëntor të 107-vjetorit të Pavarësisë dhe 75-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, le t'a kthejmë çdo tubim për festën e flamurit në një thirrje për të mbrojtur kombin dhe gjuhën tonë", ka shkruar ajo në një postim në rrjetin social "Facebook".

